



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.7/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal të Zgjedhjeve KKZ, Komuna Prishtinë, për shkak të refuzimit të kërkesës për mbajtjen e tubimit politik në Sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahet me 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.05.2026, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e PABAZUAR, ankesa ZP.Anr.7/2026, datës 21.05.2026, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Komunal të Zgjedhjeve KKZ, Komuna Prishtinë, për shkak të refuzimit të kërkesës për mbajtjen e tubimit politik në Sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahet me 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datë 21.05.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.7/2026, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën thekson se me datë 08.05.2026, Lëvizja Vetëvendosje, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, z. Egzon Balaj, ka dorëzuar formularin për njoftim për mbajtjen e tubimit publik pranë Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë, e cila datë sipas palës ankuese përkon me ditën e konstituimit të KKZ-së në Prishtinë dhe me fillimin e funksionalizimit të këtij organi në kuadër të procesit zgjedhor. Tutje në ankesë theksohet se në mbledhjen e dytë të KKZ-së në Prishtinë është vendosur që kërkesa e Lëvizjes Vetëvendosje të mos rekomandohet për miratim, me arsyetimin se Zyrtarja Ekzekutive e KKZ-së, kishte pranuar më herët, përkatësisht me datë 30.04.2026, një kërkesë nga Partia Demokratike e Kosovës për të njëjtin lokacion, dhe se, për shkak të rendit kohor të paraqitjes, përparësia i takonte subjektit tjetër politik.

Pala ankuese konsideron se ky arsyetim është juridikisht i pabazuar dhe në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Sipas kësaj dispozite, subjekti politik që dëshiron të organizojë tubim politik duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (tutje: ndërsa KKZ, pas pranimit të formularit, e regjistron atë në librin e protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohës së pranimit të njoftimit. Nga kjo rezulton se përparësia procedurale nuk krijohet nga një komunikim paraprak, nga një kërkesë e pranuar jashtë funksionimit të KKZ-

së, apo nga një veprim administrativ i Zyrtarit Ekzekutiv, por nga regjistrimi i rregullt i kërkesës në procedurën e KKZ-së, si organ kompetent dhe i konstituuar.

Po ashtu në ankesë theksohet se në rastin konkret, me datë 30.04.2026, KKZ në Prishtinë ende nuk ishte konstituuar, dhe se për rrjedhojë, në atë datë nuk ekzistonte organi kolegjal kompetent që do të mund të pranonte, regjistronte, shqyrtonte dhe vendoste mbi kërkesat për tubime politike në kuptim të Rregullores Nr. 07/2024. Pranimi eventual administrativ i një kërkesë nga Zyrtarja Ekzekutive para konstituimit të KKZ-së nuk mund të barazohet me dorëzimin, regjistrimin dhe protokollimin e kërkesës pranë KKZ-së, as nuk mund të krijojë përparësi juridike ndaj një subjekti tjetër politik. Interpretimi i kundërt do të krijonte pasiguri juridike dhe trajtim të pabarabartë të subjekteve politike. Ai do të nënkuptonte se përparësia procedurale për shfrytëzimin e hapësirave publike mund të fitohet edhe para se organi kompetent të jetë konstituuar dhe jashtë mekanizmit të paraparë me Rregullore. Pala ankuese po ashtu thekson se një qasje e tillë do ta zhvendoste vendimmarrjen nga KKZ-ja, si organ kompetent për administrimin lokal të procesit zgjedhor, te veprime paraprake administrative që nuk kanë bazë të mjaftueshme për të prodhuar pasoja juridike ndaj subjekteve të tjera politike.

Gjithashtu pala ankuese thekson se kjo çështje është sqaruar edhe në opinionin ligjor të KQZ-së lidhur me interpretimin e nenit 4 të Rregullores Nr. 07/2024, ku theksohet se përparësia për shfrytëzimin e një hapësire publike gjatë fushatës zgjedhore krijohet nga momenti i dorëzimit të formularit në KKZ dhe regjistrimi i tij në protokoll. Po ashtu, në këtë opinion sqarohet se rendi kohor i kërkesave përcaktohet nga protokollimi në KKZ ndërsa roli i KKZ-së është të garantojë rendin, barazinë dhe administrimin e drejtë të fushatës zgjedhore, dhe se për rrjedhojë, kërkesa e pretenduar e Partisë Demokratike të Kosovës e datës 30.04.2026 nuk mund të konsiderohet si kërkesë që ka krijuar përparësi procedurale në kuptim të nenit 4 të Rregullores Nr. 07/2024, për shkak se në atë moment KKZ në Prishtinë ende nuk ishte konstituuar dhe nuk kishte filluar funksionimin e saj si organ kompetent. Refuzimi i kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje, mbi këtë bazë përbën zbatim të gabuar të Rregullores, cenon parimin e sigurisë juridike dhe trajtimin e barabartë të subjekteve politike në procesin zgjedhor. Prandaj, kërkojmë që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, ta anulojë vendimin/refuzimin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë për refuzimin e kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje, dhe të konstatojë se aplikimi i pretenduar i datës 30.04.2026 nuk mund të prodhojë përparësi procedurale apo juridike ndaj kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje të dorëzuar pas konstituimit dhe funksionalizimit të KKZ-së. Pala ankuese ka bashkangjitur si provë Formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit politik.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se nga informacioni që kanë pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Prishtinës, bazuar në nenin 44 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i jep kompetencë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të miratuar rregulla specifike që lidhen me organizimin e ngjarjeve politike gjatë fushatës zgjedhore. Në bazë të kësaj kompetence KQZ ka miratuar Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar - Organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike, ku në nenin 4 specifikohet procedura e organizimit dhe mbajtjes së tubimeve publike.

-Në përgjigje nga KQZ, theksohet se më datën 08.05.2026, me vendimin Nr.01/698/2026, ka emëruar anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), për zgjedhjet e parakohshme

për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 7 qershor 2026. Sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ.

Sipas paragrafi 3 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë përmes e-mailit, formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës.

Sipas paragrafit 4 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07 /2024, KKZ, pas pranimi të formularit nga subjekti politik, e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohës së pranimi të njoftimit. KKZ, jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe Zyrën për qëllime të monitorimit.

Në përgjigje po ashtu theksohet se pas pranimi të kërkesës nga PZAP, KQZ ka kontaktuar me zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë, të cilët kanë dërguar dokumentet si në vijim, të bashkangjitur kësaj përgjigje: Formularin e Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik, të SP "Partia Demokratike Kosovës- PDK", të datës 30.04.2026, Formularin e Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik, të SP Lëvizja Vetëvendosje, e datës 20.05.2026, Pëlqimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publikë, e datës 14.05.2026, Nr.07-353/02-60490/2026, Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit Komunal i Zgjedhjeve në Prishtinë, të datës 20.05.2026.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës, si dhe përgjigjes së dhënë nga KQZ-ja, vlerëson se Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Prishtinës ka vepruar në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, kur e ka njoftuar ankuesin se nuk mund të mbahet tubimi politik i fushatës, i planifikuar për datën 06.06.2026, në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë.

Rregullorja Nr.07/2024 e KQZ-së, neni 4 paragrafi 2 parasheh që: *Subjektet e certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore sportive kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ*", ndërsa paragrafi 5 parasheh se: *KKZ mund të refuzojë kërkesën e subjektit politik, në rast se hapësira është e zënë më parë nga kërkesa e parashtruar nga subjekti tjetër politik*".

Në rastin konkret, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, z. Egzon Balaj, me datën 08.05.2026, pranë Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Prishtinë, ka dorëzuar formularin e njoftimit për mbajtjen e një tubimi publik në sheshin "Skënderbeu", të planifikuar për datën 06.06.2026. Ndërkaq, paraprakisht, me datën 30.04.2026, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar në KKZ në Prishtinë

formularin për mbajtjen e një tubimi politik, i cili po ashtu ishte planifikuar të mbahej në të njëjtën datë, respektivisht më 06.06.2026.

Pretendimet e palës ankuese Lëvizja Vetëvendosje se kërkesa e pranuar nga subjekti tjetër politik ka qene jashtë funksionimit të KKZ, nuk qëndrojnë, për arsye se KQZ më datën 08.05.2026, me vendimin Nr.01/698/2026, ka emëruar anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 7 qershor 2026, ndërsa aplikimet për mbajtjen e tubimit nga subjekti politik PDK e paraqitur me datë 30.04.2025 dhe aplikimi i subjektit politik LVV, për mbajtjen e tubimit i paraqitur me datë 08.05.2026, janë shqyrtuar nga KKZ me datë 20.05.2026, për mbajtje të fushatës në kohën dhe vendin e planifikuar nga subjekti politik i cili ka aplikuar i pari. Sipas paragrafi 3 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, është paraparë kur mund të paraqitet më së voni njoftimi, dhe nuk përcakton ndonjë afat tjetër paraprak, siç pretendohet në ankesë.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, si dhe nenit 4 par.2 dhe 5 të Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se KKZ ka rekomanduar që të miratohet kërkesa e subjektit politik PDK e cila ka paraqitur e para kërkesën për mbajtjen e tubimit politik në sheshin Skënderbeu në Komunën e Prishtinës me datë 06.06.2026.

Andaj parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.7/2026 datë 22.05.2026

**Kryesuese e panelit,
Violeta Husaj Rugova**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.23/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Delushe Halimi dhe Faton Ademi, anëtarë, lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të refuzimit të kërkesës për mbajtjen e tubimit politik në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.7/2026, të datës 22.05.2026, në seancën e mbajtur me datë, 28.05.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, (PZAP), ZP.Anr.7/2026, të datës 22.05.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.7/2026, të datës 22.05.2026, është vendosur: "REFUZOHET e PABAZUAR, ankesa ZP.Anr.7/2026, e datës 21.05.2026, e parashtuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Komunal të Zgjedhjeve KKZ, Komuna Prishtinë, për shkak të refuzimit të kërkesës për mbajtjen e tubimit politik në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahet me 07 Qershor 2026".

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën pretendon se PZAP ka zbatuar gabimisht nenin 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, dhe se vendimi i PZAP është i mangët në arsyetim, pasi që kërkesa e pretenduar e PDK-së e datës 30.04.2026, nuk mund të krijojë përparësi procedurale në kuptim të nenit 4 të rregullores, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin e PZAP, ZP.Anr.7/2026, të datës 22.05.2026, ashtu që të vendosë në mënyrë meritore në favor të ankuesit, ose ta kthejë çështjen në rivendosje.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në



ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.7/2026, datë 22.05.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 21.05.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.7/2026, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën ka theksuar se me datë 08.05.2026, Lëvizja Vetëvendosje, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, z. Egzon Balaj, ka dorëzuar formularin për njoftim për mbajtjen e tubimit publik pranë Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë, e cila datë sipas palës ankuese përkon me ditën e konstituimit të KKZ-së në Prishtinë dhe me fillimin e funksionalizimit të këtij organi në kuadër të procesit zgjedhor. Tutje në ankesë theksohet se në mbledhjen e dytë të KKZ-së në Prishtinë është vendosur që kërkesa e Lëvizjes Vetëvendosje të mos rekomandohet për miratim, me arsyetimin se Zyrtarja Ekzekutive e KKZ-së, kishte pranuar më herët, përkatësisht me datë 30.04.2026, një kërkesë nga Partia Demokratike e Kosovës për të njëjtin lokacion, dhe se, për shkak të rendit kohor të paraqitjes, përparësia i takonte subjektit tjetër politik. Pala ankuese konsideron se ky arsyetim është juridikisht i pabazuar dhe në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Sipas kësaj dispozite, subjekti politik që dëshiron të organizojë tubim politik duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (tutje: ndërsa KKZ, pas pranimit të formularit, e regjistron atë në librin e protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohës së pranimit të njoftimit. Nga kjo rezulton se përparësia procedurale nuk krijohet nga një komunikim paraprak, nga një kërkesë e pranuar jashtë funksionimit të KKZ- së, apo nga një veprim administrativ i Zyrtarit Ekzekutiv, por nga regjistrimi i rregullt i kërkesës në procedurën e KKZ-së, si organ kompetent dhe i konstituar.

Po ashtu në ankesë theksohet se në rastin konkret, me datë 30.04.2026, KKZ në Prishtinë ende nuk ishte konstituar, dhe se për rrjedhojë, në atë datë nuk ekzistonte organi kolegjal kompetent që do të mund të pranonte, regjistronte, shqyrtonte dhe vendoste mbi kërkesat për tubime politike në kuptim të Rregullores Nr. 07/2024. Pranimi eventual administrativ i një kërkesë nga Zyrtarja Ekzekutive para konstituimit të KKZ-së nuk mund të barazohet me dorëzimin, regjistrimin dhe protokollimin e kërkesës pranë KKZ-së, as nuk mund të krijojë përparësi juridike ndaj një subjekti tjetër politik. Interpretimi i kundërt do të krijonte pasiguri juridike dhe trajtim të pabarabartë të subjekteve politike. Ai do të nënkuptonte se përparësia procedurale për shfrytëzimin e hapësirave publike mund të fitohet edhe para se organi kompetent të jetë konstituar dhe jashtë mekanizmit të paraprak me Rregullore. Pala ankuese po ashtu ka theksuar se një qasje e tillë do ta zhvendoste vendimmarrjen nga KKZ-ja si organ kompetent për administrimin lokal të procesit zgjedhor, te veprimet paraprake administrative që nuk kanë bazë të mjaftueshme për të prodhuar pasoja juridike ndaj subjekteve të tjera politike. Gjithashtu pala ankuese ka theksuar se kjo çështje është sqaruar në opinionin ligjor të KKZ-së lidhur me interpretimin e nenit 4 të Rregullores Nr. 07/2024, ku



theksohet se përparësia për shfrytëzimin e një hapësire publike gjatë fushatës zgjedhore krijohet nga momenti i dorëzimit të formularit në KKZ dhe regjistrimi i tij në protokoll. Po ashtu, në këtë opinion sqarohet se rendi kohor i kërkesave përcaktohet nga protokollimi në KKZ, ndërsa roli i KKZ-së është të garantojë rendin, barazinë dhe administrimin e drejtë të fushatës zgjedhore, dhe se për rrjedhojë, kërkesa e pretenduar e Partisë Demokratike të Kosovës e datës 30.04.2026, nuk mund të konsiderohet si kërkesë që ka krijuar përparësi procedurale në kuptim të nenit 4 të Rregullores Nr. 07/2024, për shkak se në atë moment KKZ në Prishtinë ende nuk ishte konstituuar dhe nuk kishte filluar funksionimin e saj si organ kompetent. Refuzimi i kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje, mbi këtë bazë përbën zbatim të gabuar të Rregullores, cenon parimin e sigurisë juridike dhe trajtimin e barabartë të subjekteve politike në procesin zgjedhor. Prandaj, ka kërkuar që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, ta anulojë vendimin/refuzimin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë për refuzimin e kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje, dhe të konstatojë se aplikimi i pretenduar i datës 30.04.2026 nuk mund të prodhojë përparësi procedurale apo juridike ndaj kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje të dorëzuar pas konstituimit dhe funksionalizimit të KKZ-së. Pala ankuese ka bashkangjitur si provë Formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit politik.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor ka sqaruar se nga informacioni që kanë pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Prishtinës, bazuar në nenin 44 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i jep kompetencë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të miratuar rregulla specifike që lidhen me organizimin e ngjarjeve politike gjatë fushatës zgjedhore. Në bazë të kësaj kompetence KQZ ka miratuar Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar - Organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike, ku në nenin 4 specifikohet procedura e organizimit dhe mbajtjes së tubimeve publike. Në përgjigje nga KQZ, theksohet se më datën 08.05.2026, me vendimin Nr.01/698/2026, ka emëruar anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 7 qershor 2026. Sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ.

Sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë përmes e-mailit, formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës. Sipas paragrafit 4 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07 /2024, KKZ, pas pranimit të formularit nga subjekti politik, e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohës së pranimit të njoftimit, KKZ jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe Zyrën për qelime dhe monitorim. Në përgjigje po ashtu theksohet se pas pranimit të kërkesës nga subjekti politik, kontaktuar me zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë, të cilin e ka marrë në



dokumentet si në vijim, të bashkangjitur kësaj përgjigje: Formularin e Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik, të SP "Partia Demokratike Kosovës- PDK", të datës 30.04.2026, Formularin e Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik, të SP Lëvizja Vetëvendosje, e datës 20.05.2026, Pëlqimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publikë, e datës 14.05.2026, Nr.07-353/0260490/2026, Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit Komunal i Zgjedhjeve në Prishtinë, të datës 20.05.2026.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se e njëjta është e pabazuar. Paneli, vlerëson se Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Prishtinës ka vepruar në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, kur e ka njoftuar ankuesin se nuk mund të mbahet tubimi politik i fushatës, i planifikuar për datën 06.06.2026, në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë. Rregullorja Nr.07/2024 e KQZ-së, neni 4 paragrafi 2 parasheh që: Subjektet e certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore sportive kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ", ndërsa paragrafi 5 parasheh se: " KKZ mund të refuzojë kërkesën e subjektit politik, në rast se hapësira është e zënë më parë nga kërkesa e parashtruar nga subjekti tjetër politik". Në rastin konkret, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, z. Egzon Balaj, me datën 08.05.2026, pranë Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Prishtinë, ka dorëzuar formularin e njoftimit për mbajtjen e një tubimi publik në sheshin "Skënderbeu", të planifikuar për datën 06.06.2026. Ndërkaq, paraprakisht, me datën 30.04.2026, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar në KKZ në Prishtinë formularin për mbajtjen e një tubimi politik, i cili po ashtu ishte planifikuar të mbahej në të njëjtën datë dhe të njëjtin vend, respektivisht më 06.06.2026.

Paneli në fund ka shtuar se pretendimet e palës ankuese Lëvizja Vetëvendosje se kërkesa e pranuar nga subjekti tjetër politik ka qene jashtë funksionimit të KKZ, nuk qëndrojnë, për arsye se KQZ më datën 08.05.2026, me vendimin Nr.01/698/2026, ka emëruar anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 7 qershor 2026, ndërsa aplikimet për mbajtjen e tubimit nga subjekti politik PDK e paraqitur me datë 30.04.2025 dhe aplikimi i subjektit politik LVV, për mbajtjen e tubimit i paraqitur me datë 08.05.2026, janë shqyrtuar nga KKZ me datë 20.05.2026, për mbajtje të fushatës në kohen dhe vendin e planifikuar nga subjektit politik i cili ka aplikuar i pari. Sipas paragrafi 3 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, është paraparë kur mund të paraqitet më së voni njoftimi, dhe nuk përcakton ndonjë afat tjetër paraprak, siç pretendohet në ankesë. Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, si dhe nenit 4 par.2 dhe 5 të Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se KKZ ka rekomanduar që të miratohet kërkesa e subjektit politik PDK, e cila ka paraqitur e para kërkesën për mbajtjen e tubimit politik në sheshin Skënderbeu në Komunën e Prishtinës me datë 06.06.2026. Andaj parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuar si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Njoftimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij



Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të refuzimit të kërkesës për mbajtjen e tubimit politik në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me 07 Qershor 2026. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkëlqet e pretenduara në ankesë se PZAP ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të Rregullores Nr. 07/2024, duke i dhënë prioritet procedural një subjekti tjetër politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), pa u funksionalizuar Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ), nga kolegji i Gjykatës Supreme vlerësohen të pabazuara.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të zbatimit të gabuar të Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, respektivisht nenin 4 të të njëjtës rregulloreje, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se kërkesa e subjektit politik LVV është e pabazuar. Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës rezulton se, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Prishtinës ka vepruar në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, kur e ka njoftuar ankuesin se nuk mund të mbahet tubimi politik i fushatës, i planifikuar për datën 06.06.2026, në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, dhe atë me referencë në Rregulloren Nr.07/2024 të KQZ-së, ku në nenin 4 paragrafi 2 është përcaktuar se: "Subjektet e certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore sportive kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ", ndërsa paragrafi 5 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: "KKZ mund të refuzojë kërkesën e subjektit politik, në rast se hapësira është e zënë më parë nga kërkesa e parashtruar nga subjekti tjetër politik".

Lidhur me pretendimet e palës ankuese për zbatim të gabuar të dispozitës nga neni 4 i Rregullores së lartcekur, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante se e njëjta ka paraqitur kërkesën për mbajtjen e tubimit politik të fushatës para subjektit tjetër politik PDK, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e përparësisë së mbajtjes së tubimit të planifikuar më datë 06.06.2026. Për më tepër sipas KKZ, rezulton se subjekti politik LVV, këtu ankues ka dorëzuar formularin e njoftimit për mbajtjen e një tubimi publik në sheshin "Skënderbeu", të planifikuar për datën 06.06.2026, më datë 08.05.2026, pra më vonë se subjekti tjetër politik Partia Demokratike e Kosovës, i cili kërkesën në KKZ, e ka dorëzuar më datë 30.04.2026, për mbajtjen e një tubimi politik, i cili po ashtu ishte planifikuar të mbahej në të njëjtën datë dhe në të njëjtin vend, respektivisht më 06.06.2026.

Nga këto të dhëna, me të drejtë PZAP ka konstatuar se pretendimet e palës ankuese të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i ka refuzuar kërkesën e subjektit politik LVV për mbajtjen e tubimit politik në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, më 08.05.2026, me Vendimin nr. 01/698/26, të emruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të planifikuara për datën 7 qershor 2026. Ndërkohë, kërkesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës për mbajtjen e tubimit është dorëzuar më 30.04.2026, ndërsa kërkesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje është paraqitur më 08.05.2026. Në anën tjetër, me të drejtë Paneli pasi që ka vlerësuar se KKZ i ka shqyrtuar kërkesat e subjekteve të lartcekura politike më datë 20.05.2026, dhe me të drejtë ka vendosur që prioritet t'i jepet subjektit politik që kishte aplikuar i pari për zhvillimin e aktivitetit në kohën dhe vendin e kërkuar, dhe atë në mbështetje të nenit 4 paragraf 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024, sipas së cilës përcaktohet vetëm afati i fundit për paraqitjen e njoftimit, pa paraparë ndonjë afat tjetër paraprak, siç është pretenduar në ankesë. Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, edhe për kolegjin e Gjykatës Supreme është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-së se parashtuesi i ankesës nuk ka mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me paraqitjen e kërkesës ashtu siç parashihet në 4 të Rregullores së lartcekur, për çka edhe me të drejtë një ankesë e tillë është refuzuar si e pabazuar.

Në anën tjetër, kolegji i Gjykatës Supreme, ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit që kanë të bëjnë atë se vendimi i PZAP-së është i mangët në arsyetim për shkak se nuk e ka trajtuar pretendimin vendimtar të ankuesit lidhur me mungesën e KKZ-së së emëruar dhe funksionale më datë 30.04.2026, mirëpo të njëjtat pretendime janë vlerësuar të pabazuara. Kjo për faktin se, pasi që PZAP me vendimin e tij ka sqaruar se KQZ më datën 08.05.2026, me vendimin Nr.01/698/2026, ka emëruar anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 7 qershor 2026, e duke u mbështetur në nenin 4 paragraf 3 të Rregullores nr. 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar ku përcaktohet se: "Subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë përmes emailit, formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), shtojca I - Formulari për Tubimet Publike, jo më vonë se: 3.1. Njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës; 3.2. dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës", me të drejtë ka refuzuar ankesën e subjektit politik LVV.

Mbi këtë bazë, kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e lartcekura se PZAP e ka refuzuar ankesën e subjektit politik LVV, pa i dhënë përparësi këtij subjekti politik, kjo pasi që dispozita e lartcekur përcakton vetëm afatin e fundit për paraqitjen e njoftimit, pa paraparë ndonjë afat tjetër paraprak që i referohet funksionalizimit të KKZ-së. Si rrjedhojë, duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerësohet se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga çka rezulton se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e duke u mbështetur në nenin 4 paragrafët 2, 3 dhe 5 të Rregullores nr.07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, nga ka rezultuar se KKZ ka rekomanduar aprovimin e kërkesës së subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, pasi ky subjekt kishte paraqitur i pari kërkesën për mbajtjen e tubimit politik në "Sheshin Skënderbeu" më datë 06.06.2026. Si rezultat i të cekurave më lartë, si dhe për shkak se Rregullorja Zgjedhore nr.07/2024, ka përcaktuar vetëm afatin e fundit për paraqitjen e njoftimit për mbajtjen e tubimit politik, por nuk ka paraparë n



kur fillon afati për të bërë një aplikim të tillë nga subjektet politike, si dhe nuk e rregullon çështjen nëse njoftimi duhet të dorëzohet para apo pas emërimit të anëtarëve të KKZ, atëherë edhe për kolegjin e Gjykatës Supreme vendimi i kontestuar i PZAP-së, rezulton të jetë i drejtë dhe i ligjshëm, përkatësisht në përputhje me nenin 4 paragrafi 5 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AA.nr.23/2026, datë 28.05.2026

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
FAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE

Rundtori i autorizuar
Ovlašćen radnik

A handwritten signature in blue ink is written over the text 'Rundtori i autorizuar' and 'Ovlašćen radnik'.